

### Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv prezanton në Kuvendin e Shqipërisë Raportin Vjetor të AMF-së për vitin 2020

#### Vështrim mbi tregjet

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, janar-prill 2021

#### Zhvillime të tjera

- AMF nxjerr për konsultim public dhe miraton formularin “Raporti Evropian i Aksidenteve”
- AMF nxjerr për konsultim publik dhe miraton modelet e reja të policave të sigurimit të detyrueshëm
- EIOPA fillon testin e stresit në sigurime për vitin 2021
- IOSCO - Takim i Komitetit Rajonal të Evropës (ERC)

#### Publikime Profesionale

- Global Risk Regulator-Koha për të zëvendësuar infrastrukturën e thërrmuar të tregut të kapitalit
- Journal of Risk Management in Financial Institution - Volumi 14, Nr. 2

#### Informacione Ndërkombëtare

- Greqi
- Kosovë
- Kroaci
- Mali i Zi
- Serbi
- Slloveni

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

## Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së raporton në Kuvendin e Shqipërisë



27 maj 2021 - Z. Ervin Mete, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare gjatë prezantimit në Kuvendin e Shqipërisë të veprimtarisë së AMF-së për vitin 2020

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, z. Ervin Mete prezantoi, më 27 maj 2021, në seancë plenare në Kuvendin e Shqipërisë, raportin mbi veprimtarinë e Autoritetit gjatë vitit 2020. Z. Mete bëri një pasqyrim të ecurisë së tregjeve nën mbikëqyrje, si edhe masat e marra nga Autoriteti në funksion të garantimit të stabilitetit financiar përgjatë një viti të vështirë, nën efektet e pandemisë COVID-19 dhe pasojave të tërmetejeve të fundvitit 2019.

Në fjalën e tij, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv theksoi se treguesit e 3-mujorit të parë të vitit 2021 sugjerojnë se tregjet nën mbikëqyrje po i kthehen normalitetit. “Tregu i sigurimeve e mbylli 3-mujorin e parë të këtij viti me një rritje prej 12.5% të të ardhurave krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Edhe asetet neto të tregut të investimeve dhe tregut të pensioneve private shënuan rritje për 3-mujorin e parë, respektivisht me 2.4% dhe 5%,” – tha z. Mete.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv u shpreh se miratimi së fundmi nga Kuvendi i Ligjit “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” është një zhvillim i rëndësishëm. Miratimi i këtij ligji përmbush gjithashtu një nga kërkesat e Komisionit Evropian në progres-raportet e viteve të fundit. Me hyrjen në fuqi më 1 korrik, ky ligj pritet të përmirësojë disa aspekte të funksionimit të tregut të sigurimeve, si edhe të sjellë lehtësime për qytetarët.

Z. Mete informoi deputetët e Kuvendit të Shqipërisë për rolin e Autoritetit si institucioni drejtues i kapitullit 9 në negociatat për anëtarësim në Bashkimin Evropian, si edhe për drejtimet kryesore të veprimtarisë së Autoritetit përgjatë vitit 2021 dhe në vazhdim.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv theksoi se Autoriteti do të përqendrohet te ruajtja e qëndrueshmërisë dhe mbikëqyrja efektive e tregjeve, plotësimi i të gjithë kuadrit nënligjor për të bërë plotësisht të zbatueshme ligjet e reja, rritjen e kapaciteteve mbikëqyrëse, avancimin me proceset e digjitalizimit dhe përmirësimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit, si edhe ndërmarrjen e nismave për edukimin financiar dhe mbrojtjen e konsumatorit dhe investitorit.

Raportimi në seancën plenare në Kuvend, erdhi pas prezantimit *online* të bërë më 11 maj, në Komisionin Parlamentar për Ekonominë dhe Financat, mbi aktivitetin vjetor të AMF-së.

<https://amf.gov.al/news.asp?id=32701>



*11 maj 2021 - Z. Ervin Mete, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare gjatë prezantimit online në Komisionin Parlamentar për Ekonominë dhe Financat të Raportit të veprimtarisë së Autoritetit për vitin 2020*

# VËSHTRIM MBI TREGJET

## Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, janar-prill 2021

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit në periudhën janar-prill 2021 arritën vlerën 5,355 milionë lekë, ose 13.34% më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Gjatë periudhës janar-prill 2021, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 269,245 me një ulje prej 5.31% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.


Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 92.67% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë sigurimet e Jetës me 7.31%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 45.16% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 54.84% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-prill 2021, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 2,542 milionë lekë, ose 13.4% më pak se gjatë periudhës janar-prill 2020.

Gjatë periudhës janar-prill 2021, dëmet e paguara bruto të sigurimit motorik kapën vlerën 1,382 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 58.87% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Gjatë periudhës janar-prill 2021, dëmet e paguara bruto të sigurimit motorik kapën vlerën 1,382 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 58.87% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Struktura e tregut të sigurimeve, janar-prill 2021



# ZHVILLIME TË TJERA

## AMF nxjerr për konsultim publik dhe miraton formularin “Raporti Evropian i Aksidenteve”

(Ligji nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”)

**RAPORTI EVROPIAN I AKSIDENTIVE**

Ky formular i nënshkruar nga të dy drejtuesit e mjeteve konsiderohet i vlefshëm dhe përdoret për dëshmipërblimin e shpejtë në rast të aksidenteve rrugore nëse ka dëme ndaj pronës në vlerë deri 30 000 (tridhjetë mijë) lekë.

|  |   |  |   |
|--|---|--|---|
| <b>1. Data e aksidentit</b>  | Ora   | <b>2. Vendi i aksidentit ( rrethi, qyteti, adresa )</b>  | <b>3. Dëme shëndetësore</b><br>Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>  |
| <b>4. Dëme materiale mjeteve të tjera përveç A ose B:</b><br>Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> *   |   | <b>5. Dëshmitarë:</b> emër, mbiemër, adresa, tel. (saktëso nëse janë pasagjerë në mjetin A ose B).<br>Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>  | Nëse po, plotëso mbrapa   |
| <b>6. I siguruari (kontrollo policën e sigurimit)</b><br>Emër _____<br>Mbiemër _____<br>Adresa _____<br>Shteti _____<br>Email _____<br>Tel. _____  | <b>Mjeti A (i dëmtuar)</b><br><b>6. I siguruari (kontrollo policën e sigurimit)</b><br>Emër _____<br>Mbiemër _____<br>Adresa _____<br>Shteti _____<br>Email _____<br>Tel. _____   | <b>12. Rrethana të aksidentit</b><br>Vendos një “X” në secilin nga kutitë që përshkruan aksidentin<br>1 <input type="checkbox"/> I ndaluar/i parkuar<br>2 <input type="checkbox"/> nisje pas një ndalimi<br>3 <input type="checkbox"/> përpiqje të ndalonte<br>4 <input type="checkbox"/> dëlte nga parkimi, vend privat ose rrugë me përdorim privat<br>5 <input type="checkbox"/> hyrje në parkim, vend privat ose rrugë me përdorim privat<br>6 <input type="checkbox"/> hyrje në një shesh me kal rrotullues<br>7 <input type="checkbox"/> qarkullonte në një shesh me kal rrotullues<br>8 <input type="checkbox"/> godite një mjet, që ecte në të njëjtin drejtim dhe në të njëjtin rradhë<br>9 <input type="checkbox"/> godite një mjet, që ecte në të njëjtin drejtim, por në rradhë tjetër<br>10 <input type="checkbox"/> ndërrohte korsi<br>11 <input type="checkbox"/> parakalonte<br>12 <input type="checkbox"/> kthehej djathtas<br>13 <input type="checkbox"/> kthehej majtas<br>14 <input type="checkbox"/> ecte mbrapaht<br>15 <input type="checkbox"/> qëndronte aty ku kalonte sensi i kundërt<br>16 <input type="checkbox"/> vinte nga e djathta<br>17 <input type="checkbox"/> nuk kishte vend të shenjat e përparësisë apo semaforin e kuq<br>Shëno në kuti numrin total të krqve të vendosura më lart | <b>6. I siguruari (kontrollo policën e sigurimit)</b><br>Emër _____<br>Mbiemër _____<br>Adresa _____<br>Shteti _____<br>Email _____<br>Tel. _____   |
| <b>7. Automjeti</b><br>Marka dhe tipi _____<br>Targa ose nr. i shasisë _____   | <b>7. Automjeti</b><br>Marka dhe tipi _____<br>Targa ose nr. i shasisë _____  | <b>8. Shoqëria e sigurimeve</b><br>Nr. i Kartonit Jeshil _____<br>(për të huajt) (sigla e vendit) (nr.)<br><b>Kontrata e sigurimit</b> (e vlefshme deri ose <b>Kartoni Jeshil</b> ) _____<br>A është vetë mjeti i siguruar ( Kasko ) ?<br>Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>  | <b>8. Shoqëria e sigurimeve</b><br>Nr. i Kartonit Jeshil _____<br>(për të huajt) (sigla e vendit) (nr.)<br><b>Kontrata e sigurimit</b> (e vlefshme deri ose <b>Kartoni Jeshil</b> ) _____<br>A është vetë mjeti i siguruar ( Kasko ) ?<br>Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> |
| <b>9. Drejtuesi (Kontrollo dokumentet)</b><br>Emër _____<br>Mbiemër _____<br>Adresa _____<br>Shteti _____<br>Tel. email _____<br>Leje drejtimi nr. _____<br>Kategoria _____ lëshuar nga _____ më _____<br>E vlefshme deri më _____ | <b>9. Drejtuesi (Kontrollo dokumentet)</b><br>Emër _____<br>Mbiemër _____<br>Adresa _____<br>Shteti _____<br>Email _____<br>Leje drejtimi nr. _____<br>Kategoria _____ lëshuar nga _____ më _____<br>E vlefshme deri më _____ | <b>13. Grafiku i aksidentit</b><br>Tregoni: 1) planin e rrugëve; 2) drejtimin e udhëtimit të A e B; 3) pozicionin e tyre në momentin e përplasjes; 4) shenjat rrugore; 5) emrat e rrugëve  | <b>13. Grafiku i aksidentit</b><br>Tregoni: 1) planin e rrugëve; 2) drejtimin e udhëtimit të A e B; 3) pozicionin e tyre në momentin e përplasjes; 4) shenjat rrugore; 5) emrat e rrugëve   |
| <b>11. Dëme materiale të dukshme.</b><br>_____   | <b>11. Dëme materiale të dukshme.</b><br>_____  | <b>15. Firmat e të dy drejtuesve</b><br>A _____ B _____  | <b>11. Dëme materiale të dukshme</b><br>_____   |
| <b>14. Vërejtje</b>  | <b>14. Vërejtje</b>   |  | <b>14. Vërejtje</b>   |

\* Nëse ka dëme materiale në objekte të ndryshme, përvojë automjeteve A dhe B, përshkruani në rrethanat e aksidentit.  
Raporti nuk duhet korrigjuar dhe duhet të bashkëngjitet dokumentat siç sqarohen në pjesën mbrapa.

Pasi iu nënshtrua procesit të konsultimit publik, formulari u miratua nga Bordi i Autoritetit.


Linku: <https://amf.gov.al/akte.asp?id=1>

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të Ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” ka hartuar formularin “Raporti Evropian i Aksidenteve”. Pasi iu nënshtrua procesit të konsultimit publik, formulari u miratua nga Bordi i Autoritetit.

Drejtuesit e mjeteve të përfshirë në aksident rrugor për dëmet ndaj pronës me vlerë deri në 30.000 lekë, nëse bien dakord, duhet të plotësojnë, të nënshkruajnë dhe të shkëmbejnë “Raportin Evropian të Aksidenteve”. Nëse nuk bien dakord, duhet të marrin procesverbalin e konstatimit të shkeljes nga Policia Rrugore.

Raporti, i nënshkruar nga të dy drejtuesit e mjeteve, nënkupton që ngjarja ka ndodhur sipas rrethanave, modaliteteve dhe pasojave të pasqyruara në formular. “Raporti Evropian i Aksidenteve” i bashkëlidhet kërkesës për dëshmipërblim, e cila trajtohet nga shoqëria e sigurimit. Për dëmet me vlerë mbi 30.000 lekë, drejtuesit e mjeteve duhet të marrin procesverbalin e konstatimit të shkeljes nga Policia Rrugore.

## AMF nxjerr për konsultim publik dhe miraton modelet e reja të policave të sigurimit të detyrueshëm



Modelet e reja të policave gjenden në linkun e mëposhtëm:  
<https://amf.gov.al/p/rojekte.asp?id=3>

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të Ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” publikon për konsultim publik modelet e reja të policave të sigurimit të detyrueshëm, si më poshtë:

[Polica për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta \(TPL\);](#)

[Polica për sigurimin e detyrueshëm nga aksidentet e pasagjerëve në transportin publik;](#)

[Polica e sigurimit kufitar.](#)

Policat e reja të sigurimit, të miratuara nga Bordi i Autoriteti, pas procesit të konsultimit publik, reflektojnë disa nga ndryshimet kryesore të Ligjit nr. 32/2021, datë 16.03.2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, si:

- Përfshirjen e Raportit Evropian të Aksidenteve, formular i cili u shpërndahet të siguruarve së bashku me policën e sigurimit;
- Mundësinë e të siguruarit për të kërkuar dëmshpërblim direkt nga shoqëria e tij e sigurimit, në rastin kur shkaktari i aksidentit është i pasiguar apo i paidentifikuar;
- Afatet e reja për trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim;
- Rritjen e limiteve të përgjegjësisë.



## EIOPA fillon testin e stresit në sigurime për vitin 2021

<https://www.eiopa.europa.eu/>

Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA) filloi më 7 maj testin e stresit të sigurimeve për vitin 2021, për tregun evropian të sigurimeve. Testet e stresit të sigurimit vlerësojnë qëndrueshmërinë e tregut evropian të sigurimeve në rast të kushteve të pafavorshme financiare dhe ekonomike dhe identifikojnë dobësitë e tregut.

Testi i stresit 2021 përqendrohet në një skenar të zgjatur COVID-19, në një mjedis me normë interesi "të ulët, për një kohë më të gjatë". Skenari, i zhvilluar në bashkëpunim me bordin Evropian të Rrezikut Sistemik (*European Systemic Risk board, ESRB*), do të vlerësojë pasojat ekonomike të pandemisë COVID-19, të cilat ndikojnë në besimin e konsumatorit në të gjithë botën dhe zgjasin tkurrjen ekonomike. Testi i stresit do të vlerësojë ndikimin në kapital dhe pozicionin e likuiditetit për bizneset në këtë fushë.

Objektivat e testit të stresit 2021 janë:

- Të vlerësojë qëndrueshmërinë e pjesëmarrësve ndaj skenarëve të pafavorshëm parë nga perspektiva e kapitalit dhe likuiditetit, për të siguruar informacion për mbikëqyrësit nëse siguresit janë në gjendje të përballojnë goditje të rënda;
- Të marrin në konsideratë rekomandimet e mundshme për industrinë dhe të lejojnë mbikëqyrësit të angazhohen me siguresit në veprimet e mundshme përmirësuese;
- Të plotësojë vlerësimin mikroprudencial.

---

Testi i stresit 2021 përqendrohet në një skenar të zgjatur COVID-19, në një mjedis me normë interesi "të ulët, për një kohë më të gjatë".

---



Ushtrimi/testimi i vitit 2021 përfshin 44 shoqëri sigurimesh dhe risigurimesh. Shoqëritë u zgjodhën bazuar në madhësinë e tyre, mbulimin e gjerë të tregut të BE-së, linjat e biznesit të kryera (sigurim Jetë dhe Jo-Jetë), numrin e juridiksioneve të përfaqësuara, si edhe mbulimin e tregut lokal. Në total, masa e synuar, u përcaktua në bashkëpunim me autoritetet kombëtare kompetente dhe mbulon 75% të Zonës Ekonomike Evropiane bazuar në totalin e aktiveve në Solvency II.

EIOPA tani po kryen një proces pyetjesh dhe përgjigjesh për të dhënë sqarime të mëtejshme për pjesëmarrësit. Rezultatet e testit të stresit janë planifikuar të publikohen në muajin dhjetor 2021.

Peter Braumüller, nënkryetar i EIOPA-s, ndër të tjera theksoi: “Ky test stresi është i një rëndësie të veçantë sepse vlerëson qëndrueshmërinë e aftësive paguese dhe të likuiditetit të siguruesve evropianë ndaj një skenari të pafavorshëm që mund të materializohet si rezultat i një krize ekonomike dhe në një periudhë pasigurie të lartë. Skenari për testet e stresit reflekton goditje të rënda në treg, por gjithashtu do të hedhë dritë mbi qëndrueshmërinë e sektorit evropian të sigurimeve.”





## IOSCO organizoi takimin e Komitetit Rajonal të Evropës

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Titujve (IOSCO) organizoi më 10 maj takimin e Komitetit Rajonal të Evropës (ERC). Takimi u zhvillua nëpërmjet platformave online për shkak të situatës së pandemisë COVID-19.

Qëllimi i këtij takimi të ERC ishte diskutimi i punës së IOSCO-s mbi copëzimin e tregut (*Market Fragmentation*) dhe kontributi i ERC-së në këtë diskutim. Lehtësimi dhe zbutja e copëzimit të tregut kanë qenë përparësi për IOSCO-n që prej vitit 2019. Në qershor 2019, IOSCO publikoi një raport mbi copëzimin e tregut, duke identifikuar fushat brenda shërbimeve financiare ku po ndodhte fragmentimi dhe duke propozuar mënyra për të zbutur ndikimin e tij. Bordi i IOSCO-s diskutoi raportin në tetor 2019, mbështeti gjetjet e tij dhe theksoi rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit mbikëqyrës. Po ashtu u theksua rëndësia e vazhdimit të monitorimit të rasteve të copëzimit të tregut. Në atë kontekst, Bordi i IOSCO-s kërkoi përgatitjen e një raporti vjetor mbi fragmentimin e tregut, duke përdorur përvojën e Komiteteve Rajonale për të mbledhur informacionin mbi rastet e fragmentimit të tregut.

Gjatë takimit virtual u diskutua për krahasimet në kuadrin rregullator të juridiksioneve të ndryshme dhe si mund të ndihmojnë Komitetet Rajonale të IOSCO-s vendet anëtare për të fituar një kuptim më të thellë të mjedisit rregullator, juridiksionet individuale, si dhe objektivat dhe synimet e rregullave të tyre. Po kështu, u diskutua për punën e autoriteteve dhe rregullatorëve individuale për ta bërë më të lehtë për tregun e huaj të kuptojnë ndryshimet e brendshme legjislative që mund të ndikojnë në to. Kjo është e lidhur edhe me lëvizjet e kapitalit në zona të ndryshme, duke nxitur besimin e ndërsjellë dhe uljen e copëzimit të tregut.

Gjatë takimit u diskutua gjerësisht për fragmentarizimin e tregut lidhur me konceptet e “financave të qëndrueshme”, FinTech, koordinimin global (kripto-aktivet), si edhe kolegjet mbikëqyrëse.

---

Gjatë takimit virtual u diskutua për krahasimet në kuadrin rregullator të juridiksioneve të ndryshme dhe si mund të ndihmojnë Komitetet Rajonale të IOSCO-s vendet anëtare për të fituar një kuptim më të thellë të mjedisit rregullator.

---



Subjects / Reporting and Governance

## Time to replace crumbling capital market infrastructure

The pandemic has taught businesses of all shapes and sizes [Time to replace crumbling capital market infrastructure](https://www.globalriskregulator.com/Subjects/Reporting-and-Governance/Time-to-replace-crumbling-capital-market-infrastructure) outdated ways of working. It has shown that almost every industry is capable of rapid digital transformation when needed, and many industries' histories will now forever be split into two distinct chapters: pre- and post-Covid-19.

### Koha për të zëvendësuar infrastrukturën e thërrmuar të tregut të kapitalit

David E. Rutter | 6 maj 2021

<https://www.globalriskregulator.com>

Pandemia u mësoi bizneseve të të gjitha formave dhe madhësive që u duhet të rimendojnë tërësisht mënyrat e vjetruara të punës. Pandemia gjithashtu tregoi se pothuajse çdo industri është e aftë për transformim të shpejtë digjital kur është e nevojshme dhe historitë e shumë industrive tani do të ndahen përgjithmonë në dy kapituj të veçantë: para dhe pas Covid-19.

Ky moment i pashembullt në kohë paraqet një mundësi për të ndryshuar lojën për Drejtuesist Ekzekutivë që të sfidojnë modelet e biznesit të kompanive të tyre dhe të përqafojnë teknologjitë e reja që janë në dispozicion. Nevoja për të përfituar nga kjo mundësi është më e ngutshme sesa kudo në zyrat operacionale dhe ato të analizës financiare të institucioneve financiare.

...

Artikulli përshkruan kushtet e reja të krijuara nga digjitalizimi i marrëdhënieve të drejtëpërdrejta të institucioneve financiare me klientin (*front office*), nevojën për ndryshime të mëtejshme në infrastrukturë dhe përshtatjen me teknologjitë e reja për zyrat operacionale (*middle and back office*).

...

Autori thekson se duke bashkëpunuar për të pasur një platformë digjitale të zyrave operacionale (*middle and back office*) të ndërtuar me një infrastrukturë të përbashkët, institucionet financiare, të cilat janë konkurrentë të ashpër, do të jenë në gjendje të punojnë së bashku për të hyrë në mënyrë më efikase në një larmi më të madhe shërbimesh. Kjo do të rrisë konkurrencën dhe efikasitetin, do të zvogëlojë rrezikun dhe do të ulë kostot, pa kompromentuar informacionin mbi pronësinë.

<https://www.globalriskregulator.com/Subjects/Reporting-and-Governance/Time-to-replace-crumbling-capital-market-infrastructure>

henrystewartpublications.com/jrm/v14

HENRYSTEWART PUBLICATIONS

REGISTER FOR UPDATES >

HOME ALL JOURNALS FINANCE MANAGEMENT MARKETING DIGITAL REAL ESTATE / PROPERTY

Journal of Financial Compliance: Best practice articles from Clifford Chance, Barclays, Raymond James, Commerzbank & Exiger

Volume 14 (2021)

Each volume of *Journal of Risk Management in Financial Institutions* consists of four 100-page issues, published both in print and online. Articles scheduled for Volume 14 are available to view on the [Forthcoming content](#) page.


Volume 14 Number 1

Special Issue: *Impact of COVID-19 on risk management in financial institutions*

Guest Editors: Thomas C. Wilson, CEO, Allianz Ayudhya and Christian S. Pedersen, Head, Risk & Compliance, Growth Markets, Accenture

• Editorial  
Guest Editors: Thomas C. Wilson, CEO, Allianz Ayudhya and Christian S. Pedersen, Head, Risk & Compliance, Growth Markets, Accenture

SUBSCRIBE NOW >



**Revista “Menaxhimi i Riskut në Institucionet Financiare”**  
*(Journal of Risk Management in Financial Institutions)*  
**Vëllimi 14, (2021) Numri 2** <https://www.henrystewartpublications.com/>

Ky numër përmban ndër të tjera edhe artikujt e mëposhtëm:

Editorial

“Menaxhimi i rrezikut të ndryshimit të klimës”, - Til Schuermann, Anëtar i Bordit Redaktues & Partner, Oliver Wyman

“Pasiguria e ndryshimit të klimës dhe menaxhimi i rrezikut të bankës qendrore” - Dirk Broeders, Menaxher i Lartë i Rrezikut dhe Marleen Schlooz, Menaxher i Rrezikut, Divizioni i Tregjeve Financiare, De Nederlandsche Bank


“Anullimet e borxheve të institucioneve financiare dhe vendeve në zhvillim: Si të shpëtojmë nga rreziqet morale?” - Michel-Henry Bouchet, Profesor Emeritus, Shkolla e Biznesit Skema, Université Côte d’Azur, Paris-Sophia-Antipolis, Suzhou, Raleigh, Belo, France

“Si duhet të mendojnë profesionistët e rrezikut për rritjen e borxhit të korporatave?” - Dr Colin Ellis, Shërbimi i Investitorëve i Moody's

“Një test i parashikueshmërisë së qenësishme të RU (*risk unit*), një metrikë e re për të shprehur të gjitha format e rrezikut operacional në banka” - Peter Hughes, Shkolla e Biznesit në Universitetin Durham dhe Mahmoud Marzouk, Universiteti i Leicester

“Modeli i shpërndarjes autoregresive të ndryshuar në kohë me ndryshimin e paqëndrueshmërisë për testin e stresit” - Leilei Zhou, Hulumtuese Sasiore, Departamenti i Matematikës së Aplikuar dhe Statistikave dhe Wei Zhu, Profesor dhe Drejtor i Programit të Diplomuar, Departamenti i Matematikës së Aplikuar dhe Statistikave, Qendra për Financa, Universiteti Shtetëror i New York-ut në Stony Brook

“Rishikimi tërësor i Librit të Tregtimit: Qasja e re standarde dhe ndikimet në menaxhimin e rrezikut” - Pasqualina Porretta, Profesor i Asociuar i ‘Bankës dhe Financave’, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti Sapienza dhe Paolo Agnes, Profesor i Asociuar i ‘Bankës dhe Financave’, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti Ndërkombëtar Telematik UNINETTUNO



## Revista “Menaxhimi i Riskut në Institucionet Financiare” (Journal of Risk Management in Financial Institutions)

Vëllimi 14, (2021) Numri 2 <https://www.henrystewartpublications.com/>

“Anulimet e borxheve të institucioneve financiare dhe vendeve në zhvillim:  
Si të shpëtojmë nga rreziqet morale?”

*Michel-Henry Bouchet, Profesor Emeritus, Shkolla e Biznesit Skema,  
Université Côte d’Azur, Paris-Sophia-Antipolis, Suzhou, Raleigh, Belo,  
France*


Abstrakt:

Qëllimi i këtij artikulli kërkimor është të hedhë dritë mbi rrezikun e afërt që vjen nga mospagimi i borxhit që vendet kanë ndaj institucioneve financiare, në prag të krizës pandemike. Artikulli analizon se ka pasur kërkesa në rritje për të lënë mënjane lidhjen midis lehtësimit të borxheve dhe kushtet për vendet në zhvillim, në mënyrë që anulimet e borxheve të bëhen menjëherë, pa vendosur kritere të performancës ose dëshmi të përmbushjes së tyre. Megjithatë, deri më sot, anulimet e borxheve nuk kanë bërë sa duhet dallimin midis përfituesve nga vendet në zhvillim, duke u bazuar në performancën e tyre dhe në politikat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Gjithashtu, anulimet e borxheve nuk kanë marrë parasysh zotimet për përmirësimin e qeverisjes. Kjo pavarësisht kërkesave të bëra nga programet për uljen e varfërisë, të cilat përfshijnë edhe shoqërinë civile. Kështu, institucionet financiare ndërkombëtare përballen me rrezikun e anulimeve të mëdha të borxheve, në një kohë të brishtësisë së portofolit për shkak të një mjedisi me norma të ulëta interesi, fitimi të ulët dhe rritje të dobët ekonomike.

Ky artikull argumenton se shumë nga rezistenca e kreditorëve privatë vjen nga skepticizmi i rrënjosur thellë, nëse lehtësimi i borxheve dhe anulimet apo fshirjet e tyre çojnë në përmirësim të qëndrueshëm të aftësive të kreditit. Artikulli evidenton se administrimi i kujdesshëm i rrezikut kërkon t'i rezistohet thirrjeve për lehtësimin e borxhit, kur ka pak hapësirë për përmirësimin e qeverisjes. Institucionet financiare duhet të këmbëngulin në kritere të rrepta në lidhje me politikat gjithëpërfshirëse të zhvillimit. Ndërsa po diskutohet aktualisht legjislacioni i ri për të lehtësuar marrëveshjet e ristrukturimit të borxhit, (me gjasë në kurriz të institucioneve financiare private) insistimi për “ndarje të drejtë të barrës” midis kreditorëve zyrtarë dhe privatë duhet të jetë një thirrje zgjimi për bankat.

Artikulli përshkruan një sërë instrumentesh të administrimit të rrezikut financiar, të cilat mund të lidhin lehtësimin e borxhit me angazhimet e gjera të qeverisjes, duke përfshirë këmbimet e borxheve, klauzolat e rikuperimit dhe riciklimin e monitoruar të lehtësimit të shërbimit të borxhit në projekte me përparësi të lartë. Kriza pandemike u ofron institucioneve financiare një mundësi për të shndërruar lehtësimin e borxhit në një levë për përmirësimin e perspektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, pra aftësi më të mirë kredimarrëse.



## **GREQI**

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Shoqata Greke e Kompanive të Sigurimeve, HAIC, ka publikuar shifrat paraprake të tregut të sigurimeve në vend, për tremujorin e parë të vitit 2021. Vëllimi i primeve të shkruara bruto për tregun e sigurimeve të Jetës dhe Jo-Jetës u rrit me 8.1% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar duke arritur në 1.07 miliardë euro.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2021, tregu i sigurimeve të Jetës u rrit me më shumë se 14% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke arritur në 518.7 milionë euro.

Rezultatet e tregut të sigurimeve për tremujorin e parë të viti 2021, të botuara nga HAIC, përfshijnë informacionin nga 18 kompani sigurimesh të cilat janë aktive në sigurimin e Jetës (dhe përbënin 99.8% të totale të tregut të Jetës për vitin 2021) dhe 45 kompani sigurimesh që janë aktive në sigurimet e Jo-Jetës (dhe përbënin 94.6% të totalit të tregut të Jo-Jetës).

## **KOSOVA**

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas të dhënave të publikuara nga Banka Qendrore e Kosovës, BQK, tregu i sigurimeve të Kosovës arriti në 25.7 milionë euro, në fund të tremujorit të parë të vitit 2021, duke shënuar një rritje prej 12.5% më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar.

Asetet totale të kompanive të sigurimeve të Kosovës u rritën gjatë tremujorit të parë 2021, duke arritur në 224.5 milionë euro.

Informacioni i publikuar në faqen e internetit të BQK-së tregon se vëllimi i primeve të shkruara bruto të sigurimit të Jetës u rrit, duke arritur në 1 milionë euro. Në të njëjtën kohë, vëllimi i primeve të shkruara bruto të sigurimit të Jo-Jetës u rrit me 11% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke arritur në 24.7 milionë euro. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto vjen nga kontratat e sigurimit MTPL të cilat siguruan 13.7 milionë euro, policat e sigurimit kufitar sollën 1.1 milionë euro prime dhe 9.8 milionë euro prime u siguruan nga klasat e tjera të sigurimeve.

## KROACI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas shifrave tremujore të botuara në faqen *online* të Byrosë Kroate të Sigurimeve, vëllimi i primeve të shkruara bruto të siguruesve kroatë, gjatë tremujorit të parë të vitit 2021, u rrit me 6.29% në terma vjetorë, duke arritur në 3.25 miliardë HRK, ose rreth 430 milionë euro.

Primet e shkruara bruto të sigurimeve të Jo-Jetës u rritën me 8.95% në terma vjetorë dhe arritën në 2.47 miliardë HRK. Ndërsa tregu i sigurimeve të Jetës pësoi rënie me 1.28%, krahasuar me periudhën janar-mars 2020, duke arritur në 784 milionë HRK.

## MALI I ZI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Siç pasqyrohet në shifrat zyrtare paraprake, vëllimi i primeve të shkruara bruto për siguruesit e Malit të Zi u ul me 3.85% gjatë tremujorit të parë të vitit 2021, duke arritur në 23.84 milionë euro.

Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Malit të Zi (*Insurance Supervision Agency of Montenegro, ISA*), raportoi se vëllimi i primeve të shkruara bruto të Jo-Jetës arriti në 19.86 milionë euro gjatë periudhës janar-mars 2021, duke shënuar një rënie prej 3.30% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Rënie pësoi edhe tregu i sigurimit të Jetës, ku vëllimi i primeve të shkruara bruto arriti në 4.08 milionë euro, duke shënuar një rënie prej 6.40%. Ndërkohë, gjatë tremujorit të parë 2021, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, dëmet e paguara bruto u rritën me rreth 12% duke arritur në 10.13 milionë euro, të ndara në:

- Pagesat e dëmeve në tregun e sigurimeve të Jetës u rritën me 51.37% duke arritur në 2.17 milionë euro;
- Pagesat e dëmeve në tregun e sigurimeve të Jo-Jetës u rritën me 4.31% duke arritur në 7.97 milionë euro.

Në tregun e sigurimeve në Malin e Zi veprojnë nëntë kompani sigurimesh, katër shoqëri sigurimi të Jetës dhe pesë në tregun e sigurimeve të Jo-Jetës.

## SERBI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas shifrave të Bankës Kombëtare të Serbisë, NBS, në fund të vitit 2020, tregu serb i sigurimeve shënoi një rritje vjetore të vëllimit të primeve të shkruara bruto prej 2.3%, duke arritur në 110 miliardë RSD, ose rreth 935 milionë euro.

Sigurimet e Jo-Jetës përbënin 76.2% të vëllimit të primeve të shkruara bruto, duke arritur në 83.8 miliardë RSD, me një rritje prej vetëm 1.7% në terma vjetorë. Primet e sigurimit të Jetës zinin 23.8% të totalit të tregut dhe u rritën me 4.4% në terma vjetorë.

Linjat më të mëdha të biznesit në sigurimet e Jo-Jetës ishin dy nënklasat motorike, MTPL dhe sigurimi Kasko. Në totalin e primeve të shkruara bruto MTPL zinte rreth 32.9% të totalit të primeve, sigurimi Kasko zinte rreth 9.6%. Ndërsa sigurimi i pronës (zjarri, rreziqet shtesë dhe dëmtimet e tjera të sigurimit të pronës) llogariten për 18.7% të totalit të vëllimit të primeve të shkruara bruto.

Vlera totale e dëmeve të paguara ishte 50.2 miliardë RSD ose rreth 427 milionë euro, nga të cilat dy nënklasat motorike, MTPL dhe Sigurimi Kasko, së bashku zinin më shumë se një të tretën e totalit të dëmeve të paguara.

## SLLOVENI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas publikimeve nga Shoqata Sllovene e Sigurimeve, (*Slovenian Insurance Association's*) tregu i sigurimeve në vend arriti në fund të vitit 2020 një total prej 2.57 miliardë euro, duke shënuar një rritje prej 2.07% në krahasim me vitin e kaluar. Kjo rritje erdhi kryesisht si pasojë e rritjes së tregut të sigurimit të Jo-Jetës i cili u rrit me 3.23%, duke arritur në një vëllim total të primeve të shkruara bruto prej 1.82 miliardë euro, ose 70.84% të vëllimit total të primeve. Ndërsa sigurimi i Jetës shënoi rënie prej -0.63% karahasur me një vit më parë, duke arritur në 749.22 milionë euro.

Sa i përket dëmeve të paguara gjatë vitit 2020, vlera totale e tyre arriti në 1.62 miliardë euro, nga të cilat rreth 530 milionë euro ishin të lidhura me policat të sigurimit të Jetës, 503 milionë euro ishin pagesa në lidhje me kontratat e sigurimit shëndetësor dhe 358 milionë euro ishin pagesa të lidhura me dëme për sigurimet motorike (MTPL dhe sigurimet Kasko).



---

**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

Për informacion të mëtejshëm  
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë  
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686  
[amf@amf.gov.al](mailto:amf@amf.gov.al) | [www.amf.gov.al](http://www.amf.gov.al)